

VENDIM
Nr. 591, datë 18.10.2017

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN
NR. 807, DATË 16.11.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DISIPLINIMIN
E ANGAZHIMEVE BUXHETORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, 40 dhe 51, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas shkronjës “dh”, të pikës 3, të vendimit nr. 807, datë 16.12.2016, të Këshillit të Ministrave, shtohet shkronja “e”, me këtë përmbajtje:

“e) fondet e shpërndara me vendim të Këshillit të Ministrave, për vitin 2017.”.

2. Ngarkohen të gjitha institucionet e njësisë të qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi